



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENTI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSh. Nr. 607/24

Paneli Shqyrtues i Prokurimit, i emëruar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) në bazë të nenit 105 dhe 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042 (i amendamentuar), në përbërje nga Batisha Ibrahim - Kryetare, Kimete Gashi dhe Vedat Poterqoi – Anëtar të Panelit, pas shqyrtimit të kërkesës për diskualifikim të ushtruar nga Komuna Gjakovë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), (Nr.Protokolli 607/24), ushtruar ndaj Operatorit Ekonomik Kadir Butuç B.I, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Furnizim me perde, me nr: te prokurimit: 632-24-4882-1-2-1, duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës dhe nenit 32 të Rregullores së Punës së OSHP, me 11.02.2025, mori:

V E N D I M

1. **Aprovohet**, si e bazuar kërkesa e Komunes së Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, e datës 03.07.2024, kurse OE Kadir Butuç B.I, me nr. unik: me nr. Unik 811012351, diskualifikohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për periudhën kohore në kohëzgjatje 3/tre muaj, duke filluar nga data 11.02.2025 deri me datën 10.05.2025, për shkak se nuk ka vepruar në harmoni me nenin 25.9 të Rregullores për prokurim publik 001/2022.

A R S Y E T I M

Kërkesa e AK- Komuna Gjakovë:

1. Autoriteti kontraktues pretendon se OE Kadir Butuç B.I, si pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me perde, me nr: te prokurimit: 632-24-4882-1-2-1, pas përfundimit të vlerësimit të ofertave dhe rekomandimit për kontratë OE Kadir Butuç B.I nuk është përgjigjur lidhur me kërkesën e AK-se për deshmim të pershtatshmerise, konkretisht vertetimat e ATK-se dhe të Gjykate kompetente. Përkunder afatit të dhënë nga AK-ja, OE Kadir Butuç B.I, nuk i ka dorëzuar deshmim të pershtatshmerise dhe sipas AK-se kemi vazhduar me operatorin ekonomik të detyrues me radhë.

Kërkesa e OSHP-së drejtuar Operatorit Ekonomik:

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me te pranuar kërkesën e datës: 03.07.2024, te AK - Komuna Gjakovë, me datën 04.07.2024 e ka njoftuar OE Kadir Butuç B.I, me qellim qe operatori ekonomik ne fjale te jap faktet dhe argumentet e veta lidhur me kërkesën e AK-se.

OE Kadir Butuç B.I, deri me sot nuk ka pranuar asnje pergjigje lidhur me kerkesen e AK-se.

Vlerësimi i pretendimeve te autoritetit kontraktues për marrjen e masave ndaj Kadir Butuç B.I

Paneli shqyrtues, bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe provat e administruara, ka konstatuar se qëndrojnë pohimet e AK-se, sikurse janë përshkruar ato ne kërkesën e datës: 03.07.2024, sepse OE Kadir Butuç B.I, nuk ka vepruar sipas dispozitave nenit 25 paragrafi 9 i Rregullores per Prokurim Publik nr. 001/2022.

Operatori ekonomik Kadir Butuç B.I, është tërhequr nga aktiviteti i prokurimit pas dorëzimit te ofertave, duke vepruar ne kundërshtim me nenin 25 te Rregullores për Prokurim Publik nr: 001/2022, i cili e obligon operatorin e rekomanduar për kontrate te dorëzojë vërtetimet ne lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë.

Organi Shqyrtues i Prokurimit është i obliguar që të merr masa ndaj operatorëve ekonomik vetëm nëse AK-ja, ka ofruar prova ashtu siç potencohet në nenin 99 të LPP-së, në të cilin flitet për funksionet dhe kompetencat e OSHP-së, në paragrafin 2 te këtij neni, ku thuhet: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare, e që në rastin konkret AK-ja, ka dorëzuar prova se OE Kadir Butuç B.I, me nr unifikues: 811012351, i cili është tërhequr nga aktiviteti i prokurimit, në fazën e vlerësimit të ofertave.

25.9 Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkohen të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë. **Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më shumë se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se.**

Paneli shqyrtues, vlerëson se janë plotësuar kushtet për zbatim te nenit 99 paragrafit 2 te LPP-se, për marrjen e masave eventuale sipas nenit te cituar me lart, sepse veprimet e operatorit ekonomik pas dorëzimit te ofertave sanksionohen me dispozitat e neneve te përmendura me lart.

Duke ju referuar të lartcekurave si dhe duke u bazuar në nenin 99.2 të LPP-së, Paneli shqyrtues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, paneli shqyrtues vendos që OE Kadir Butuç B.I me nr unifikues: 811012351, të vendoset në listën e zezë në kohëzgjatje prej tre (3) muaj kalendarak.

Duke ju referuar të lartcekurave si dhe duke u bazuar në dispozitivin e nenit 99.2 të LPP, Paneli shqyrtues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarija e Panelit
Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, kurse pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet me kërkesëpadi Gjykatës Kompetente për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna Gjakovës

1x1 OE Kadir Butuc B.I..

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së